

PLAKU SOFRONI



131.

Lutja e pastër nuk ju jepet atyre që studiojnë shumë. Sipas këtij mendim, rruga e shkencës teologjike nuk është aspak efikas dhe rrallë çon drejt lutjes së pastër dhe të përzemërt!

132.

Teologjia është gjendje e shpirtit, e realizuar prej bekimit të Perëndisë! Këtu gjendet ndryshimi midis teologjisë dhe filozofisë, midis teologjisë së vërtetë dhe teologjisë së intelektualëve. Në qoftë se një frymëzim i tillë na i prek zemrën, ajo nuk do të ketë më fund në tokë. Ajo është e pashtershme, sepse në të gjendet fillimi i jetës së përjetshme. Në qoftë se edhe përbërja juaj trupore tretet ky frymëzim do të jetojë tek ju me një fuqi të jashtëzakonshme!

133.

Zoti mund ta prekë shpirtin e njeriut dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i japë vetënjojhe. Ekziston ndryshim i madh midis kësaj njohjeje dhe asaj që fitohet në shkollat teologjike. Mund të jetë shumë e rrezikshme të studiohet teologjia pa përvojën egzistencionale të jetës, në Shpirtin e Krishtit. Jemi me të vërtetë në rrezik, ta studiojmë teologjinë në format e saj apofatike, si poezia apo filozofia. Ka rrezik të përvetësojmë ndonjë qëndrim të gabuar, të mendojmë se jemi diçka e madhe, gjë që është e mjaftueshme të humbasim. Jemi të detyruar të kërkojmë në jetë një tjetër lloj frymëzimi, në Krisht.

134.

Shkenca teologjike që mësohet në shkolla dhe e cila u bë disiplinë shkencore e kapshme për të gjithë, nuk na mundëson njohje me Zotin. Njohja e Zotit burron prej jetës në Zot, që lind në brendësi të zemrës.

135.

Është e mundur të bëhemi viktimë të iluzionit shpirtëror, në qoftë se më tepër e vlerësojmë atë që na i jep shkenca teologjike, sesa shenjtëria e jetës!

136.

Ndonjë mund të jetë shumë i mësuar, të ketë diploma akademike, por deri në fund të ngelet i paditur për rrugën e shpëtimit. Kur dikush ka vetdijë dhe jetë pa mëkate, dituria intelektuale mund të japë fruta të çuditshme. Përkundrejt kësaj, dituria pa dashuri, nuk mund ta shpëtojë njeriun!

137.

Pa shpirtin e pendimit, pa përvojën e bindjes së vërtetë, askush nuk mund të bëhet teolog apo klerik i vërtetë, domethënë, person i aftë për t'i mësuar të tjerët në rrugën e vërtetë të krishterë.

138.

Që ta mësojmë mënyrën e jetës në Krisht, nuk është e nevojshme të lexojmë dhjetëra apo qindra libra. Ati im shpirtëror më këshillonte të lexoja vetëm disa faqe në ditë. Pesëmbëdhjetë minuta, gjysëm ore, por të kujdesem ta realizoj atë që kam lexuar në jetën time.

PËR SHPIRTIN DHE JETËN

139.

Shën. Apostull Petar për *mbretërinë e shenjtë* thotë, se mund të realizohet me pjesëmarjen tonë në Liturgjinë e Shenjtë. Besueshëm, frikësohuni të shkoni në Liturgji prej shprehisë. Mundohuni gjithmonë më thellësishtëm ta jetoni atë që e ka jetuar Krishti gjatë kohës së Mbrëmjes së Mistershme, kur e ngriti këtë fshehtësi të madhe, Shënjtoria Evharia. Atëherë, Liturgjia do të tregohet shpëtuese jo vetëm për ju, por dhe për të gjithë ata që marin pjesë në të. Nuk ju përket vetëm klerikëve t'i përjetojnë në zemrat e tyre mundimet e Krishtit për shpëtimin e botës, Ai, prapë, është viktimë e mëkatit dhe vdekjes!

140.

Çdo gjë që ekziston, ekziston sepse Zoti mendon për të! Zoti mendon për botën dhe bota ekziston! Në qoftë se e kërkoni vullnetin e Zotit, thjeshtësisht dhe me qetësi, Zoti mund të ndryshojë çfarëdo lloj gjendjeje, madje dhe më negativen. Si rrjedhim në qoftë se i bindeni Atit tuaj shpirtëror, në qoftë se keni besim në të, mos kini frikësoni se mund t'ju udhëheqë gabimisht. Zoti gjithmonë do të gjejë mënyrë që t'ia u zbulojë të vërtetën. Duke ndjekur me bindje, e bëni zemrën tuaj më të ndjeshme për çdo lëvizje shpirtërore të jetës suaj.

141.

Nuk është shumë e rëndësishme, në qoftë se përsosmëria e Atit tonë shpirtëror nuk është e përkryer. Zoti do t'i dërgojë veprat tona deri në masën në të cilën ato kryhen me bindje dhe besim te Krishti. Ajo që na duket e gabueshme, do të bëhet e drejtë. Përkundrejt kësaj, ajo që na duket e përkryer në logjikën tonë, shumë herë nuk është asgjë tjetër, veçse reflektim i vullnetit tonë mëkatar, kështu që Zoti nuk do të jetë me ne.

142.

Rruga më e thjeshtë tek Krishti është të jemi të bindshëm dhe të mos e imponojmë vullnetin tonë. Ajo është lufta më e fuqishme kundër pasioneve!

143.

Që ta kuptojmë të fshehtën e jetës te Krishti, jemi të detyruar ta kalojmë rrugën e bindjes. Dhe të ecim me shumë kujdes. Në qoftë se vëzhgimi është i drejtë, njeriu mund të ketë frymëzim duke e bërë dhe punën më të thjeshtë si për shembull përgatitjen e ushqimit. Përkundrejt kësaj, mosbindjeje, qofshi edhe patriark peshkop dhe klerik mund të humbisni.

144.

Në vetvete e mbartim mëkatit e parë, atë helm të tundimit të parë të Adamit në parajsë *do të jemi si Zoti* por, bindja mund të na çlirojë nga kjo gjendje.

145.

Gjithçka varet nga marrëdhënia jonë me Zotin. Në qoftë se kemi besim në Mendimin e Tij, do të gjejmë fuqi ta ndjekim fjalën e Atit tonë shpirtëror. Logjika që është karakteristikë për jetën e përditshme dhe mendimeve tona, nuk është e mjaftueshme. Zoti e lë atë që ka besim shumë të madh në arsyen e vet! Nuk ka rëndësi të madhe në qoftë se ndonjë fjalë e Atit shpirtëror është kundër nesh apo në qoftë se, ndonjë këshillë na duket e paarsyeshme për logjikën e përgjithshme. Në qoftë se, jemi të përgatitur ta ndjekim Fjalën, këshillat, në qoftë se kemi besim të madh te Ai, atëherë Zoti do t'i rregullojë punët kështu që fundi të jetë pozitiv. Fshehtësia e bindjes është një nga gjërat më serioze në rrugën drejt shpëtimit.

146.

Zoti ju ruajtë! Dhe ju mbaheni qëndrimin e duhur. Nga jashtë asgjë nuk duket. Ajo është një jetë për të cilën nuk mund të themi asgjë të veçantë, por, nga Brenda, për shkak të bindjes, gjendemi në gjendje të përgatitjes së vazhdueshme. I tillë duhet të jetë i krishteri: Një tel prej tensionit të lartë, në të cilën mund të qëndrojnë një zog pa patur gjatë kësaj as plagën më të vogël, por nëpër të cilën kalon energji e aftë ta shkatërojë të gjithë botën. Ja, në cilën mënyrë e prekim mbretërinë e përjetshme të Krishtit.

PLAKU SOFRONI PËR SHPIRTIN DHE JETËN

147.

Me ngritje të vogël të bindjes, njeriu hyn në qenien e pa fillimshme të Zotit.

148.

Bindja është e domosdoshme për shpëtimin e përjetshëm! Përgatiteni zemrën tuaj dhe mendjen tuaj! Mbani qëndrim të brendshëm pozitiv.

149.

Të jemi sipas shembullit të Zotit! Nuk mund ta arrijmë këtë, përveç se nëpërmjet bindjes, ngjashëm me bindjen e Krishtit, të Shën Mërisë, dhe të të gjithë atyre që i ndiqnin hapat e tyre.

150.

Kur jemi mbledhur të gjithë së bashku jemi të detyruar të jemi si një njeri sipas shembullit të Zotit të trefishtë, i Cili është vetëm një Zot! Këtë nuk mund ta arrijmë, përveç se nëpërmjet futjes së Shpirtit të Shenjtë në vetvete. Në qoftë se kemi çrregullsi të brendshme të mendimeve tona të këqia, mundimet do t'i kemi të pasuksesshme. Si ta fitojmë këtë bekim? Si të jetojmë, që Zoti dhe Shpirti i Shenjtë të jetojnë tek ne? Duhet të jemi të bindshëm! Vetëm, në qoftë se gjithmonë bëjmë kujdes për vëllain tonë arrijmë të krijojmë tek ne një lloj *radari*, që ta ndiejmë atë që të tjerët e mendojnë, vullnetin e tyre dhe gjendjen e tyre shpirtërore. Përkundrajt kësaj, mos bindja, sidomos, në qoftë se në fillim e kërkojmë qetësinë tonë, do të jemi të ndarë prej të tjerëve dhe s'do të jemi të bashkuar.

151.

Bindja shpirtërore është e domosdoshme për jetën e përditshme! Ta respektojmë vullnetin e të tjerëve më tepër sesa tonin! Ta pranoni me qëndrim pohues çdo kërkesë të klerikut tuaj, të vëllait apo motrës, kështu që do të krijoni dalngadalë, brenda jush dhe rreth jush, një atmosferë të këndshme dhe zemra juaj do të bëhet shumë e butë, shumë e ndjeshme për çdo lëvizje të brendshme, për të gjitha ndryshimet shpirtërore.

152.

Kur e mbledhim arsyen tonë, çdo njëri prej nesh, le t'i luttet Zotit të na japë shpirt të bindjes të vullnetit të Tij dhe të na bekojë të gjithëve. Qoftë më i vjetri, qoftë më i ri, me zemër ta dëgjoni të afërmin tuaj, që të kuptoni kur shpirti i Zotit flet nëpërmjet tij. Një dhjak njëzetvjeçar Shën Atanasij i Madh dhe jo patriakët, as peshkopët apo martirët e tjerë, ishte ai që e solli fjalën *njëqenësor*. Në mbledhjen e parë kozmike në vitin 325, që ta përcaktojë marrëdhënien e Atit dhe Birit në Trininë e Shenjtë. Por që ta arrijmë këtë duhet të bëjmë shumë mundim por do ta arrijmë vetëm me bindje!

Plaku Sofroni
PËR SHPIRTIN DHE JETËN

Biblioteka FJALA PREJ VODOÇËS

EDICIONI:
BANORËT E MALIT TË SHENJTË

LIBRI 2

Titulli në origjinal

PLAKU SOFRONI (SAHAROV)

PËR JETËN DHE SHPIRTIN

Përktheu nga greqishtja

Peshkopi i Strumicës Zoti NAUM

KISHA ORTHODHOKSE MAQEDONASE
EPARKIA STRUMICË



превод на албански:
Јордана Шемко